


01-1608



Në bazë të nenit 21, 22 dhe 44 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 20/21 qershor 2016), nenit 27 dhe 28 të Ligjit Nr. 04/L-110 për Ndërtim (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 18/03 korrik 2012), nenit 17 pika “d” e Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr. 03/L-040 dt.20.02.2008, nenit 15 pika “d” e Statutit të Komunës së Prishtinës Nr.110-391 dt. 25.02.2010, dispozitave të nenit 12 të Udhëzimit Administrativ MMPH Nr. 05/2017 për mbikëqyrje inspektuese dhe procedurën për lëshimin e certifikatës së përdorimit, dhe duke vendosur sipas kërkesës 05 Nr. 391/02-213032/22 dt. 06.10.2022, të kërkuesve / bashkëpronarëve, Bahri Rexhepi, Arben Shabani, Beqir Krasniqi, Mihrije Smajli, Behxhet Salihi, Rashit Rexhepi, Sima-Com, Muhamed Qerimi dhe Fatmir Krasniqi dhe Investitorit “Sima Com” Dega në Kosovë, për lëshimin e certifikatës së përdorimit, për ndërtesat shumëbanesore me afarizëm, përkatësisht: Ndërtesa “Sima Com 4A”, Ndërtesa “Sima Com 4B”, dhe Ndërtesa “5”, e ndërtuara, në kuadër të bllokut urbanistik, “A14” dhe “A14”, të tërsisë “A”, të Planit Rregullues “Mati 1”, në rr. “Agim Fortuzi” dhe “Andrea Aleks” në Prishtinë, Drejtoria e Urbanizmit, e Komunës së Prishtinës, në procedurë të rregullt administrative, me datë 06.01.2023, lëshon këtë:

### CERTIFIKATË E PËRDORIMIT

**I. I LEJOHET** kërkuesve / bashkëpronarëve, Bahri Rexhepi, Arben Shabani, Beqir Krasniqi, Mihrije Smajli, Behxhet Salihi, Rashit Rexhepi, Sima-Com, Muhamed Qerimi dhe Fatmir Krasniqi dhe Investitorit “Sima Com” Dega në Kosovë, sipas kërkesës 05 Nr. 391/02-213032/22 dt. 06.10.2022, përdorimi i ndërtesave shumëbanesore me afarizëm, përkatësisht: Ndërtesa “Sima Com 4A”, me etazhitet B+P+5, e ndërtuar sipas Vendimit për Lejimin e Ndërtimit, 05 Nr. 351/02-224711/19 dt. 25.11.2019, Ndërtesa “Sima Com 4B”, me etazhitet B+S+P+6, e ndërtuar sipas Vendimit për Lejimin e Ndërtimit, 05 Nr. 351/02-0191358/19 dt. 125.11.2019 dhe Ndërtesa “5”, me etazhitet B+S+P+5, e ndërtuar sipas Vendimit për Lejimin e Ndërtimit, 05 Nr. 351/02-0191323/19 dt. 17.11.2019, në parcelat kadastrale nr. 678-8 e evidentuar në certifikatën e pronësisë P-71914050-00678-8, ZK Matiçan, dhe nr. 1658-0 e evidentuar në certifikatën e pronësisë P-71914050-01658-0, ZK Matiçan, konkretisht në kuadër të bllokut urbanistik, “A14” dhe “A14”, të tërsisë “A”, të Planit Rregullues “Mati 1”, në Prishtinë.

II. Ndërtesa nga pika I. e këtij vendimi, ndodhet në rrugën “Agim Fortuzi” ku ka dalje hyrjet me numrat: 37, 39, 41, 43, 25, 27, 29, 31, 15, 17, 19, 21 dhe 23 dhe në rrugën “Andrea Aleks” ku ka dalje hyrjet me numrat: 14, dhe 16 në Prishtinë, dhe e njejta do të përdoret dhe shfrytëzohet sipas destinimit të caktuar me leje ndërtimi dhe dokumentacionin ndërtimor, nga dita e marrjes në dorëzim të këtij vendimi të certifikatës së përdorimit.

III. Kjo Certifikatë do të shërbejë si bazë për regjistrimin e ndërtesave dhe njësive të tyre në evidencat e regjistrit kadastral.

VI. Pjesë përbërëse e këtij vendimi të certifikatës së përdorimit është dokumentacioni sipas Shtojca 5 e Udhëzimit Administrativ MMPH Nr. 05/2017 për mbikëqyrje inspektuese dhe procedurën për lëshimin e certifikatës së përdorimit.

### A r s y e t i m

Kërkuesit / bashkëpronarët, Bahri Rexhepi, Arben Shabani, Beqir Krasniqi, Mihrije Smajli, Behxhet Salihi, Rashit Rexhepi, Sima-Com, Muhamed Qerimi dhe Fatmir Krasniqi dhe Investitorit “Sima Com” Dega në Kosovë, me kërkesën 05 Nr. 391/02-213032/22 dt. 06.10.2022 i janë drejtuar kësaj Drejtorie, për lëshimin e certifikatës së përdorimit për ndërtesën shumëbanesore me afarizëm, përkatësisht Ndërtesa “Sima Com 4A”, me etazhitet B+P+5, Ndërtesa “Sima Com 4B”, me etazhitet B+S+P+6, Ndërtesa “5”, me etazhitet B+S+P+5, në kuadër të bllokut urbanistik, “A14” dhe “A14”, të tërsisë “A”, të Planit Rregullues “Mati 1”, në Prishtinë, konkretisht në kuadër të parcelave kadastrale nr. nr. 678-8 dhe 1658-0, ZK Matiçan, ndërtuar sipas Vendimeve për Lejimin e Ndërtimit, 05 Nr. 351/02-224711/19 dt. 25.11.2019, 05 Nr. 351/02-0191358/19 dt. 125.11.2019, 05 Nr.

351/02-0191323/19 dt. 17.11.2019, të lëshuara nga Drejtoria e Urbanizmit e Komunës së Prishtinës si dhe pranuar teknikisht nga komisioni përkatës.

Paraprakisht Drejtoria e Inspeksionit-Sektorit i Ndërtimit, e Komunës së Prishtinës, përmes shkresave zyrtare "Akt përcjellës", me referencë: 09 Nr. 391/02-119164/22 dt. 29.07.2022, për Ndërtesën "Sima Com 4A", 09 Nr. 391/02-1191787/22 dt. 29.07.2022, për Ndërtesën "Sima Com 4B" dhe 09 Nr. 391/02-119164/22 dt. 29.07.2022, për Ndërtesën "5", ka përcjellë në Drejtorinë e Urbanizimit, Raportet e Inspektimit Final të punëve dhe përshkrimet të dokumentacionit, hartuar nga ekipi profesional i Drejtorisë së Inspeksionit të Komunës së Prishtinës.

Me kërkesë, kërkuessit kanë prezantuar dokumentacionin sipas Shtojca 5 të e Udhëzimit Administrativ MMPH Nr. 05/2017 për mbikëqyrje inspektuese dhe procedurën për lëshimin e certifikatës së përdorimit: Lista kontrolluese e Protokollit të Inspektimit/1.Inspektimi i themelit; Lista kontrolluese e Protokollit të Inspektimit/2.a.1.Inspektimi i pjesëve strukturore-Strukturave të betonit para instalimit të derdhjes; Lista kontrolluese e Protokollit të Inspektimit/2.a.2.Inspektimi i pjesëve strukturore-Strukturat e betonit; Lista kontrolluese e Protokollit të Inspektimit/2.c.Inspektimi i pjesëve strukturore-Strukturat e çelikut; Lista kontrolluese e Protokollit të Inspektimit/2.d.Inspektimi i pjesëve strukturore-Strukturat e drurit; Lista kontrolluese e Protokollit të Inspektimit/3.Inspektimi i instalimit elektrik; Lista kontrolluese e Protokollit të Inspektimit/4.Inspektimi i instalimeve të ujit; Fotografji gjatë procesit të ndërtimit; Dëshminë mbi pagesën e lejes ndërtimore; Atestet e materialeve dhe rezultatet e testeve, certifikatat; Raportin e përfundimit të punëve të arkitekturës, nga mbikqyrësi Blerina Tanushaj/Donjeta Alloqi; Raportin e përfundimit të punëve të konstruksionit, nga mbikqyrësi Sami Idrizi; Raportin e përfundimit të punëve të instalimeve të ujësjellësit dhe kanalizimit, nga mbikqyrësi Armend Rexhpi; Raportin e përfundimit të punëve të instalimeve elektike, nga mbikqyrësi Valon Hajrizaj; Raportin e përfundimit të punëve të instalimeve makinerike, nga mbikqyrësi Bekim Tola; Incizimin gjeodezik të objektit, dhe rregullimit të jashtëm-gjendjen e realizuar, me vijën rregullative dhe vijën ndërtimore e vendosur në sistemin koordinativ sipas Kosovaref 01, nga gjeodeti i licensuar Faton Bejselmani me nr. të licensës 125;

Drejtoria e Urbanizmit, pas pranimit të kësaj kërkesë dhe shqyrtimit të saj, provave të lëndës, mendimit profesional të organit kompetent, Raportet e përfundimit të punëve, sipas fazave, dhe Raportin e Inspektimit Final, ka konstatuar se:

Në raportet përfundimtare të inxhinierëve të fazave të ndërtimit: arkitekturë, strukturë, instalimet e ujësjellësit dhe kanalizimit, instalimet elektrike, konstatohet se punët janë zhvilluar në harmoni me dokumentacionin ndërtimor/projektin kryesor, si dhe me normat dhe standardet në fuqi, gjegjësisht ndërtesat shumëbanesore me afarizëm mund të përdoren.

Bazuar në nenin 27 dhe 28 të Ligjit Nr. 04/L-110 për Ndërtim dhe dispozitat e nenit 12 të Udhëzimit Administrativ MMPH Nr. 05/2017 për mbikëqyrje inspektuese dhe procedurën për lëshimin e certifikatës së përdorimit, ku thuhet se lëshimi i certifikatës së përdorimit mund të bëhet nëse kërkesat nga Ligji për Ndërtim janë plotësuar, organi kompetent lëshon certifikatën e përdorimit brenda kohës së caktuar.

Andaj, bazuar në konstatimet e mësipërme dhe në raportet e prezentuara-bashkangjitura në kërkesë, kjo drejtori konstatoi që ndërtesa shumëbanesore me afarizëm mund të përdoret, gjegjësisht vendosi të lëshojë certifikatën e përdorimit për ndërtesën shumëbanesore me afarizëm.

Bazuar në konstatimet e më sipërme u vendos si në dispozitiv të kësaj Certificate.

**Udhëzimi juridik:** Pala e pakënaqur me këtë Certificate, me ankesë mund t'i drejtohet kësaj drejtorie brenda afatit, brenda afatit prej 30 ditësh, duke llogaritur nga dita e marrjes në dorëzim të kësaj Certificate. Bazuar në vlerësimin nga kjo drejtori, ankesa do të shqyrtohet apo do të përcillet te organi epror – MMPHI-ja.

**I dorëzohet:** Kërkuessve/Investitorit, Drejtorisë së Kadastrit, Drejtorisë së Inspeksionit, kësaj drejtorie, Qendrës për shërbim me qytetarë dhe në dosje të lëndës.

**DREJTORIA E URBANIZMIT E KOMUNËS SË PRISHTINËS,  
05 NR. 391/02-213032/22 DT. 06.01.2023**

Zyrtarja,  
Bahtije Vllasaliu

U.D. Udhëheqëse e Sektorit,  
Nazife Krasniqi

Drejtori,  
Arber Sadiki

Faqe 2 prej 2

